

Zbatimi i programeve të seleksionimit sanitar të kultivarëve autoktonë me rëndësi kombëtare për krijimin e Burimeve Primare si e vetmja alternativë për rikuperimin e germoplazmës së hardhisë.

Përcaktimi dhe zbatimi i teknikave efikase të shëndetësisimit si kultura e majave meristematike dhe termoterapisë *in vitro* dhe *in vivo* të disa kultivarëve të hardhisë nga viruse ose patogjenë të ngjashëm me to.

Shëndetësimi i plotë i materialit bimor pa prani virusesh dhe patogjenesh.

Përdorimi i materialit mbjellës të pastër duke ruajtur saktësinë gjenetike dhe gjendjen fitosanitare.

Harmonizimi dhe standartizimi i certifikimit të fidanëve në shkallë rajonale dhe kombëtare, me rëndësi ekonomike, në tregtimin e tyre.

Laboratori *in vitro* punon prej shumë vitesh në fushën e kulturave qelizore e indore për shtimin e nënshartesave drufrutore bërthamore në prodhimin e materialit bimor të kontrolluar duke siguruar pastërtinë fitosanitare, saktësinë gjenetike dhe korrespondencën varietale.

Aktivitetet kryesore të laboratorit *in vitro*.

- Seleksionimi dhe shtimi i materialit bimor në drufrutorë bërthamorë me anë të teknikës inovative *in vitro* realizohet me qëllim përftimin e një produkti të pastër në aspektin fitosanitar, si dhe rigjenerimin e koleksioneve autoktone drufrutore me material bimor të pastër.

- Shtimi me teknikat inovative *in vitro* i disa specieve të "vështira" në kultivimin në mënyrë vegjetative tradicionale: a) specie që rrënjëzohen me vështirësi b) specie të vështira në shtim (arra, shega,

## QENDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE VLORE

### SHTIMI *IN VITRO* I NËNSHARTESAVE



ELEKTRA SPAHIU

E-mail [qttpemtarivlore@yahoo.com](mailto:qttpemtarivlore@yahoo.com)



**NËNSHARTESË  
DARDHË  
(OHxF 333)**



**NËNSHARTESË  
KUMBULL (29/C)**



**NËNSHARTESË  
QERSHI  
(GISELA)**



**NËNSHARTESË  
PJESHKË  
GF-677**

Transferimi i teknikave inovative demonstrative, didaktike dhe divulgative në angazhimin dhe pjesëmarrjen në fushën e kërkimit, transferimit të teknologjive të reja për fermerët, në njohjen dhe përhapjen e materialit bimor të çertifikuar, në mënyrë që fermerët të përdorin fidanë të çertifikuar dhe të evitojnë prodhimin e materialit shumëzues me origjinë të dyshimtë.



**STEVIA  
REBAUDIANA**



**BIMË  
MJEKËSORE**




Ruajtja dhe konservimi i germoplazmës autoktone drufrutore (*pemë frutore*) në



bazë të teknikave alternative të ruajtjes së materialit gjenetik, si mbartëse

në kushte *in vitro* e karakteristikave të vlef-



shme për përmirësimin e kultivarëve me qëllim krijimin e bankës së

germoplazmës autoktone *in vitro* dhe rigjenerimin e koleksioneve të ndryshme bimore. Transferimi i teknologjive inovative e bashkëkohore në shtimin *in vitro* të kultivarëve autoktonë dhe të huaj drufrutorë, në prodhimin e materialit bimor të kontrolluar me rëndësi prioritare për zhvillimin cilësor të